



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0919

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani dhe Kimete Gashi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE “Limit Project” SH.P.K., kundër Njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “034-Ndertimi i Objektivit të Kompleksi i UCK-se – objekti i C-se Skenderaj” me numër të prokurimit:643-25-5186-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komuna Skenderaj, më 12/11/2025, mori këtë:

Vendim

- Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE “Limit Project” SH.P.K.me nr. 2025/0919 e datës 18/09/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “034-Ndertimi i Objektivit të Kompleksi i UCK-se – objekti i C-se Skenderaj” me numër të prokurimit:643-25-5186-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK)Komuna Skenderaj, **ndërsa AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.**
- Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarrë lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
- Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.
- OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 16.06.2025 Komuna Skenderaj në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “034-Ndertimi i Objektivit të Kompleksi i

UCK-se – objekti i C-se Skenderaj” me numër të prokurimit: 643-25-5186-5-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë, vlera e parashikuar e kontratës: 3,995,500.00 €.

Me 08.09.2025, OE “Limit Project” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Kërkesa i është refuzuar si e pa bazuar nga Autoriteti Kontraktues.

Me 18.09.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Limit Project” SH.P.K. me nr. 2025/0919 lidhur me aktivitetin e prokurimit “034-Ndërtimi i Objektivit të Kompleksi i UCK-se – objekti i C-se Skenderaj” me numër të prokurimit 643-25-5186-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Limit Project” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi 1

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Skenderajt (pavarësisht që ka respektuar brenda 10 ditëve vendimin e OSHP-së) gjatë zbatimit të Njoftimit për përmirësimin e gabimit – Formularin B54 – nuk ka ekzekutuar ndryshimet ashtu si janë kërkuar nga OSHP-ja.

OSHP-ja thekson si vijon:

Paneli shqyrtues, pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike dhe mbështetjes në Ligjin për Prokurim Publik (LPP) si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa duhet të aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues ka vendosur që duhet të përmirësohet Dosja e tenderit/Njoftimi për Kontratë i Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Objektivit të Kompleksit të UÇK-së – objekti i Ç-së, Skenderaj” me numër të prokurimit 643-25-5186-5-1-1, pasi është vlerësuar se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore.

Kjo specifikohet edhe më qartë:

Paneli shqyrtues ka gjykuar bazuar edhe në natyrën e këtij aktiviteti dhe praktikën, sidomos te ky Autoritet Kontraktues, se shumicën e kontratave me vlera të mëdha i ka pasur vetëm me një ose dy ofertues, por i dyti ka rezultuar i papërgjegjshëm për shkak të kërkesave të rrepta të vendosura nga AK.

Pra, ky konstatim i OSHP-së paraqet se Autoriteti Kontraktues Komuna Skenderaj po shkel qëllimisht Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, respektivisht:

- Neni 7: Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi
- Neni 1, Pika 1: Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

6. Raporti i vlerësimit të riskut për kompani për të gjitha pozitat e kërkuara

Ne kërkojmë që kjo kërkesë të largohet pasi kemi ankesa edhe për pikat më lartë dhe në momentin që të pranohet kërkesa jonë, ky raport është i paarsyeshëm të qëndrojë. Për mos të qenë diskriminues, kjo procedurë – raporti për të gjitha pozitat e kërkuara – duhet të largohet.

Përgjigja paraprake nga Autoriteti Kontraktues

Ky kriter është formuluar në përputhje me Nenin 68 dhe 69 të LPP-së dhe nuk krijon pengesa për konkurrencë, përkundrazi është kërkesë që dëshmon se kompania dhe stafi kanë certifikimin e nevojshëm për realizimin e projektit sipas kushteve të sigurisë, shëndetit dhe riskut sipas standardeve dhe legjislacionit të kërkuar në vendin tonë.

Ankesa në OSHP

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues është e mangët dhe nuk trajton në mënyrë të plotë dhe të arsyetuar thelbin e ankesës sonë. Kërkesa që të dorëzohet raport i vlerësimit të riskut për të gjitha pozitat e kërkuara është e panevojshme dhe e paarsyeshme, dhe bie ndesh me parimet e proporcionalitetit dhe konkurrencës së ndershme.

Në përputhje me praktikat e prokurimit publik, mjafton që operatori ekonomik të ketë një raport të përgjithshëm të vlerësimit të riskut në nivel kompanie, si pjesë e dokumentacionit standard të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Kërkesa që një raport rishikimi të bëhet individualisht për secilën pozitë të ofruar në kuadër të projektit është tepër specifike, nuk ka bazë reale teknike për këtë fazë të tenderimit dhe për pasojë ka efekt kufizues dhe diskriminues ndaj pjesëmarrësve të tjerë në procedurë.

Për më tepër, duke qenë se kemi ngritur edhe ankesa të tjera për specifikimet e stafit profesional (pretendimet 3 deri 9), kërkesa për raport rishikimi për secilën pozitë humbet objektin e saj dhe bëhet e pavlefshme në momentin kur kërkesat për personelin nuk janë më të qëndrueshme.

Në këtë kontekst, kërkojmë që ekspertit shqyrtues të vlerësojë këtë kriter si joproporcional, i pajustificuar dhe i panevojshëm teknikisht, dhe që në përputhje me ligjin të rekomandojë largimin e tij nga dosja e tenderit në mënyrë që të garantohet konkurrencë reale dhe mosdiskriminim ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Kthimi i përgjigjes nga OSHP

Lidhur me kriterin: 4. Lista e stafit profesional dhe stafit teknik – origjinal e nënshkruar dhe vulosur, vlerësimi i riskut për këto vende të punës. Certifikatat e trajnimeve nga MPMS ose nga ndonjë kompani e licencuar prej MPMS – kopje origjinale.

Eksperti shqyrtues ka theksuar si vijon:

Pretendimi nr.3 i OE ankues pretendon se: “Raporti i vlerësimit të riskut për kompani për të gjitha pozitat e kërkuara. Ne kërkojmë që kjo kërkesë të largohet pasi kemi ankesa edhe për pikat më lart dhe në momentin që të pranohet kërkesa jonë ky raport është i paarsyeshëm të qëndrojë, për mos të qenë diskriminues kjo procedurë – raporti për të gjitha pozitat e kërkuara të largohet.”

Vlerësimi i ekspertit është që pretendimi ankimor në rastin konkret është i bazuar, pasi OE-të mund të angazhojnë persona/ekspertë të fushave të caktuara të cilët nuk janë staf i rregullt i kompanisë dhe në këtë mënyrë është e pamundur që të ofrohet vlerësimi i riskut për të gjitha këto pozita, andaj rekomandojmë që të kërkohet vlerësimi i riskut për kompani, siç pretendon OE ankues.

Mos-trajtimi i AK lidhur me Vendimin e OSHP-së

Ankimim:

Duke e ditur që Paneli ka konstatuar:

Lidhur me pretendimet tjera me nr. rendor 2 dhe 3 të radhitur në raportin e ekspertizës, respektivisht sa i përket kërkesave lidhur me stafin dhe raportin e vlerësimit të riskut për kompani për të gjitha pozitat e kërkuara, Paneli Shqyrtues i mbështet arsyetimin e ekspertit shqyrtues pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish dhe kërkon që AK të bëjë përmirësimet edhe sa i përket këtyre rekomandimeve.

Bazuar në dosjen finale, Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur asnjë ndryshim nga kriteri paraprak, dhe kjo tregon se i njëjti nuk ka respektuar “Vendimin e OSHP-së”.

Propozim për marrje të vendimit

Andaj, kërkojmë që sa më parë ky kriter të largohet ose të përmirësohet ashtu si ka kërkuar edhe Paneli dhe Eksperti Profesional.

Pretendimi 2

4.1. Menaxheri i Projektit

Inxhinier apo Master i diplomuar në Ndërtimtari, me të paktën 7 vite përvojë pune pas diplomimit. Të jetë i certifikuar si Auditor i Cilësisë ISO 9001, Auditor për sistemet e menaxhimit të sigurisë OHSAS 18001, specialist i mjedisit dhe i certifikuar për organizimin dhe menaxhimin e punishteve të ndërtimit.

Ankesa: Të gjitha këto certifikime janë të panevojshme dhe kufizuese, pasi shumica e ndërtuesve të mëdhenj punojnë pa këto certifikime. Kërkojmë që këto certifikime të hiqen nga dosja, pasi janë të panevojshme dhe kufizuese.

4.2. Inxhinier ose Master i diplomuar i Arkitekturës

Me të paktën 2 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit. Të jetë i certifikuar për auditimin e energjisë në ndërtesa dhe si Ekspert i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë nga MPMS/MFPT.

Ankesa: Certifikimet nga MPMS/MFPT janë diskriminuese dhe të panevojshme, pasi inxhinieri nuk mund të mbajë përgjegjësi të plotë për sigurinë, dhe nuk është roli i tij kryesor.

4.3. Inxhinier apo Master i diplomuar i Hidroteknikës

Me të paktën 3 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit, certifikuar për Ekspert të SSHP nga MFPT, me Certifikim për Menaxhimin e Projekteve IPMA minimum niveli D, Auditor i Cilësisë ISO 9001 dhe certifikim për organizimin dhe menaxhimin e punishteve të ndërtimit.

Ankesa: Certifikimi për SSHP nga MFPT dhe certifikimi IPMA niveli D janë diskriminues dhe favorizues, pasi kompania fituese deri tani nuk ka përfunduar asnjë projekt me këtë staf. Kërkojmë largimin e këtij kriteri për të garantuar konkurrencë të lirë.

4.4. Inxhinier apo Master i diplomuar i Hidroteknikës

Me të paktën 7 vite përvojë pune, certifikuar për instalimin e gypave dhe sigurinë e kanalit.

Ankesa: Kërkesa për certifikim për instalimin e gypave dhe sigurinë e kanalit është e tepërt dhe kufizuese, pasi diploma dhe përvoja janë më të rëndësishme se ky certifikim. Kërkojmë heqjen e këtij certifikimi.

4.5. Inxhinier apo Master i diplomuar i Gjeodezisë

Me të paktën 3 vite përvojë pune, i licencuar, dhe i certifikuar për organizimin dhe menaxhimin e punishteve të ndërtimit.

Ankesa: Certifikimi për menaxhimin e punishteve është i panevojshëm dhe kufizues për këtë profesion.

4.6. Inxhinier apo Master i diplomuar i Ndërtimtarisë

Me të paktën 5 vite përvojë pune, i certifikuar dhe trajnuar për penetrim ose testim vizual.

Ankesa: Kërkesa për certifikim dhe trajnim për penetrim ose testim vizual është diskriminuese dhe favorizon operatorë të caktuar. Kërkojmë heqjen e saj.

4.7. Inxhinier apo Master i diplomuar i Mjedisit

Me të paktën 5 vite përvojë pune, i certifikuar si ekspert i SSHP nga MFPT, për mbrojtje nga zjarri nga AME dhe për vlerësimin e rrezikut nga AME.

Ankesa: Certifikimet janë kufizuese dhe diskriminuese. Kompanitë që kanë punuar në projekte të ngjashme nuk posedojnë këto certifikime, prandaj kërkojmë heqjen e tyre për të mundësuar pjesëmarrjen në tender.

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues:

Autoriteti ka deklaruar se kriteret për staf janë përcaktuar në përputhje me Nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP Nr.03/L-241), duke synuar sigurimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale për realizimin e projektit. Sipas tyre, kriteret nuk krijojnë pengesa të panevojshme për konkurrencë.

Ankesë në përgjigjen e Autoritetit Kontraktues:

Përgjigja është e mangët dhe nuk adreson në mënyrë substanciale pretendimet tona. Kërkesat për certifikime të shumta dhe specifike janë të panevojshme, diskriminuese dhe kufizuese. Ato:

- Nuk korrespondojnë me natyrën e kontratës.
- Kufizojnë padrejtësisht pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të kualifikuar.
- Synojnë orientimin e procedurës drejt një operatori të paracaktuar.

Kërkojmë rishikimin e kriterëve në përputhje me parimet e proporcionalitetit, konkurrencës së lirë dhe trajtimit të barabartë.

Vendimi i OSHP-së:

Paneli shqyrtues mbështet arsyetimin e ekspertit dhe rekomandon që Autoriteti Kontraktues të bëjë përmirësimet e nevojshme në përputhje me rekomandimet e tyre.

Kërkesë për veprime:

Kërkojmë që të vepohet sipas rekomandimit të Panelit Shqyrtues dhe Ekspertit Profesional, duke larguar të gjitha certifikatat ISO dhe klasifikimet, kualifikimet që nuk janë të lëshuara në Kosovë, në përputhje me rekomandimet e Odës së Inxhinierëve të Kosovës.

Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë përgjigje për pretendimin tonë lidhur me Stafin. Dosja e tenderit nuk ka pësuar asnjë ndryshim, duke shkelur Nenin 108/a të LPP-së, që e obligon AK të përgjigjet për çdo pretendim ankimor të ngritur nga pala ankimuese.

Pretendimi 3

Për ekspertin profesional dhe teknik:

Duke konsideruar që përgjigja e Autoritetit Kontraktues (AK) nuk ka trajtuar në mënyrë të plotë, të arsyetuar dhe profesionale ankesën tonë lidhur me kriteret teknike të vendosura për stafin profesional, kërkojmë nga ekspertët e OSHP-së që të kryejnë një shqyrtim të detajuar, të paanshëm dhe profesional për secilin inxhinier të kërkuar në dosjen e tenderit. Kjo për të vlerësuar nëse kërkesat janë të justifikuara teknikisht dhe në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe parimet e konkurrencës së ndershme.

Kërkesa jonë për vlerësim specifik për secilin pozicion:

1. Menaxheri i Projektit: Vlerësohet nëse kërkesa për certifikime si ISO 9001, OHSAS 18001, specialist i mjedisit dhe menaxhim punishtesh është e nevojshme dhe e proporcional për rolin e menaxherit, apo përbën një ngarkesë të panevojshme dhe kufizuese.
2. Inxhinieri i Arkitekturës: Vlerësohet nëse certifikimet për auditim energjetik dhe ekspertizë për siguri dhe shëndet në punë janë të lidhura dhe proporcionale me detyrat e arkitektit.
3. Inxhinieri i Hidroteknikës (pozita 4.3 dhe 4.4): Shqyrtohen kërkesat për certifikime të shumta (SSHP, IPMA niveli D, auditor cilësie ISO 9001, organizim punishtesh) dhe nëse ato përbëjnë kufizime të panevojshme teknike.
4. Inxhinieri i Gjeodezisë: Analizohet relevanca e certifikimeve për organizimin dhe menaxhimin e punishteve për profesionin e gjeodezisë dhe ndikimi i tyre në përmbushjen cilësore të kontratës.
5. Inxhinieri i Ndërtimtarisë: Vlerësohet nëse kërkesat për trajnime të specializuara si penetrimi dhe testimi vizual janë domosdoshmëri teknike për projektin apo përjashtojnë pa arsye pjesëmarrës të kualifikuar.

6. Inxhinieri i Mjedisit: Analizohen kërkesat për certifikime të shumta (SSHP, mbrojtje nga zjarri, vlerësim risku) nëse janë të domosdoshme apo tejkalojnë kërkesat minimale profesionale.

Kërkesë për veprime:

- Të veprohet në përputhje me rekomandimet e PSH-së dhe ekspertit profesional, duke larguar kërkesat për certifikime ISO dhe klasifikime të tjera që nuk janë të lëshuara në Kosovë, në përputhje me rekomandimet e Odës së Inxhinierëve të Kosovës.
- Autoriteti Kontraktues është i obliguar të japë përgjigje të detajuara mbi secilin pretendim ankimor sipas nenit 108/a të Ligjit për Prokurimin Publik.

Pretendimi 2: Pajisjet/Makinat

Kritikë ndaj listës së pajisjeve dhe specifikimeve të tyre:

- Kërkesat për 43 pajisje të ndryshme me specifikime shumë të ngushta (tonazh/fuqi të fiksuar) janë teknisht të paarsyeshme dhe joproportionale me natyrën dhe vlerën e projektit (~4 milionë euro).
- Kriteret janë të dizajnuara për të favorizuar operatorë të caktuar duke kufizuar konkurrencën dhe duke shkelur parimet e konkurrencës së lirë dhe mosdiskriminimit sipas Ligjit për Prokurimin Publik (neni 7, paragrafi 4 dhe 6).
- Tonazhet e përcaktuara për makineritë janë shumë të kufizuara (p.sh. eskavatorë 12-14t, 20-23t, buldozherë 7-8t, 30-34t, etj.) dhe nuk justifikohen nga nevojat reale të projektit, duke përjashtuar operatorë me pajisje të ngjashme me kapacitete pak më të vogla ose më të mëdha.
- Kërkesat për pajisje si pompë betoni me lartësi min. 62m, lift ndërtimi 35-40m me peshë bartëse 800-1000kg, vinç me platformë, dhe gjeneratorë me fuqi të lartë janë teknike të panevojshme dhe diskriminuese pasi vetëm një ose dy kompani i zotërojnë.

Kërkesë për përmirësim dhe veprim nga AK:

- Të rishikohet dhe korigjohet lista e pajisjeve duke vendosur vetëm minimumet e nevojshme teknike, pa kufizime të ngushta tonazhi dhe specifikime që diskriminojnë operatorë të tjerë.
- Të zbatohen rekomandimet e OSHP-së dhe të largohen kriteret që favorizojnë operatorë të caktuar.
- Të sigurohet që kriteret të jenë në përputhje me parimet e ligjit dhe konkurrencën e ndershme.

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues dhe qëndrimi ynë:

- AK ka bërë disa përmirësime duke vendosur toleranca 10-20% në kapacitetet e pajisjeve, por përsëri kriteret mbeten kufizuese dhe nuk përmbushin plotësisht kërkesat e OSHP-së dhe ankesat tona.
- AK duhet të marrë masa aktive për të eliminuar diskriminimet në kriteret teknike.

Në rast se nuk ndryshohet qasja e AK-së, ne do të drejtohem edhe në institucione të tjera kompetente, përfshirë Komisionin për Rishqyrtim të Procedurave të Prokurimit Publik (KRPP) dhe organet gjyqësore.

Pretendimi 4

Në OSHP, më 18.09.2025:

Autoriteti Kontraktues ka vendosur të devijojë përgjigjen mbi pretendimin tonë ankimor. Pretendimi ynë ankimor ishte:

“Të gjitha këto kritere janë KUFIZUESE, ku përcaktohen produkte specifike, të cilat janë të rralla në treg ose i ka vetëm 1 ose 2 kompani në Kosovë. Si Operator Ekonomik, kemi pajisje të cilat i tejkalojnë kërkesat e AK-së, mirëpo kufizimi me 1/2/3 ton është kufizim i pajisjeve. Autoriteti Kontraktues duhet përmes formularit të përmirësimit të gabimit të përcaktojë MINIMUMIN ose MAKSIMUMIN, por jo nga deri, pasi që në këtë formë përcakton kufizim dhe përcaktim se kush do të jetë fituesi.”

Pra, edhe vetë OSHP ka paraqitur vendim të tillë, që pajisjet specifike duhet të jenë me një MINIMUM ose MAKSIMUM, por jo kufizim i pajisjes, pasi që “divergjencat” në 1/2/3 tonë për një pajisje paraqesin kufizim të plotë. Duhet të kuptohet se OSHP ka përcaktuar se ju, si Autoritet Kontraktues, si rezultat i kërkesave specifike keni vazhdimisht 1 ose 2 oferta. Andaj kërkojmë nga ana juaj, si Autoritet, të respektoni vetëm Ligjin, Rregulloren, Udhëzuesin dhe tani edhe Vendimin e OSHP-së.

Sepse këto pajisje/makineri të kërkuara, edhe pse kanë një tolerancë në peshë, disa prej tyre janë me peshë shumë të lartë dhe mund të kufizojnë konkurrencën, dhe eksperti shqyrtues nuk është marrë fare me pretendimin se Lift ndërtimi 35-40m/800-1000kg është evident diskriminues — këtë lloj pajisjeje e posedon vetëm 1 operator në treg.

Mendojmë se Autoriteti Kontraktues, duke mos e respektuar Vendimin e OSHP-së, duhet të paraqesë ndryshimet e kërkuara nga PSH-OSHP dhe, duke parë shkeljet e paraqitura në detaje në:

A. Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092;

B. A01. Rregulloren për Prokurimin Publik.

Duke e ditur rëndësinë e këtij projekti si OE, nuk e kemi kuptuar ende qëllimin e Komunës së Skenderajt për të neglizhuar një projekt të tillë.

Lidhur me pretendimet e OE “Limit Project” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0919 ka vlerësuar si në vijim:

Të gjitha pretendimet ankimorë sipas ankesës 919/25 kanë të bëjnë me çështje që janë trajtuar paraprakisht nga OSHP përmes raportit të ekspertit dhe vendimit të OSHP-së nr.586/25.

OSHP përmes vendimit të nr.586/25 ka obliguar AK-në që të bëjë korrigjimet e dosjes së tenderit, ku përveç rekomandimeve të ekspertit lidhur me korrigjimin e dosjes sa i përket ISO standardeve dhe vlerësimit të riskut, vendimi i OSHP po ashtu ka obliguar AK-në të korrigjojë në dosje edhe kërkesat lidhur me pajisjet, pasi është vlerësuar se kërkesat e për pajisje pasi disa prej tyre janë me peshë shumë të larta dhe mund të kufizojnë konkurrencën, dhe eksperti shqyrtues nuk është marrë fare me pretendimin se Lift ndërtimi 35–40m / 800– 1000kg Evident diskriminues – këtë lloj pajisjeje e posedon vetëm 1 operator në treg.

Pas analizimit të pretendimeve ankimore dhe dosjes së korrigjuar eksperti shqyrtues vlerëson se AK nuk e ka respektuar në tërësi vendimin e OSHP-së 586/25.

Megjithëse AK e ka ulur kërkesën për qarkullim nga 7.9 në 7 milion euro dhe ka hekur kërkesën që menaxheri të jetë i certifikuar si auditor për ISO 9001, kemi vërejtur se AK përsëri nuk ka hekur kërkesën për pozita të caktuara, dhe kjo kërkesë gjendet te pikat 4 dhe 5 tek Kërkesat mbi

mundësitë teknike dhe/ose profesionale në dosje të tenderit.

Po ashtu shihet se në dosje përsëri qëndrojnë kërkesat për makineri me pesha shumë të larta siq është potencuar në vendimin e OSHP-së.

Bazuar në këto që u cekën më lart, vlerësojmë se pretendimet ankimore janë të bazuara dhe se AK nuk e ka zbatuar në tërësi vendimin e AK.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë duke i bazuar në konstatimet e ekspertit shqyrtues është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “034-Ndertimi i Objektivit të Kompleksi i UCK-se – objekti i C-se Skenderaj” me numër të prokurimit: 643-25-5186-5-1-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues të cilave ja u fal besimin ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “Limit Project” SH.P.K. aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “034-Ndertimi i Objektivit të Kompleksi i UCK-se – objekti i C-se Skenderaj” me numër të prokurimit: 643-25-5186-5-1-1 që AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim. Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, rrjedhimisht paneli shqyrtues konstaton që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, ndersa AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat

relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III dhe IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - K.K. SKENDERAJ**
- **OE - LIMITPROJECT SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: